



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPLJAN			
PRANUAR MË: PRIMLJENO DANA:		19.02.2026	
NJËSIA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT BR. KLASIFIKACIJE	NR. LËNDËS BR. PREDMETA	SHTOJCA PRILOG
01-	052/01-	8992	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

ZYRA E KRYETARIT

Datë:	19.02.2026
Referencë:	
Për:	Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi – Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit
Kopje:	Diamant Bytyqi – Nënkryetar i Komunës
Nga:	Komisioni për hartimin e Rregullores në bashkëpunim me Zyrtarin përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e konsultimit publik në Komunën e Lipjanit.
Lënda:	Raport nga procesi i konsultimit publik nga Draft-Plani Komunal për Riintegrimin e Qëndrushëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunen e Lipjanit (2026-2028)

Hyrje

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-016/0163314, e datës 26.12.2024 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në komunë, Komuna e Lipjanit harton Raport nga procesi i konsultimit publik të Draft-Plani Komunal për Riintegrimin e Qëndrushëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunen e Lipjanit (2026-2028)

Me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politik bërjes dhe vendimmarrjes së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, Komisioni për hartimin Draft–Plani Komunal për Riintegrimin e Qëndrushëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunen e Lipjanit (2026-2028) së bashku me zyrtarin përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e zbatimit e konsultimit publik në Komunën e Lipjanit kanë shpallur në:

KONSULTIM PUBLIK

Draft–Plani Komunal për Riintegrimin e Qëndrushëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunen e Lipjanit (2026-2028)

Njoftimit i është bashkangjitur edhe linku i konsultimeve publike dhe linku i platformes për konsultime publike të Qeverisë së Kosovës, ku ka qenë në diskutim publik ky dokument si edhe informatë shtesë se kujt i adresohen komentet.

Shih linqet:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42974>

<https://lipjan.rks-gov.net/dokumentet-ne-konsultim-publik/>

Ecuria e Procesit

Komisioni për hartimin e Statutit në bazë të ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe dispozitatat e Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna. Në bashkëpunim me kordinatorin për konsultime publike kanë publikur në web faqen e komunës njoftimin me datë 02.02.2026 për mbajtjen e konsultimit-debatit **Draft–Plani Komunal për Riintegrimin e Qëndrushëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunen e Lipjanit (2026-2028)**

në linkun:

<https://lipjan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/02/Njoftim-per-debat-publik-1.pdf>

Ndërsa takimi konsultativ-debati është realizuar në kohën e paraparë dhe me dt. 09.02.2026 është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Lipjanit duke filluar nga ora ora 10:00

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në vegëzën:

Linku: <https://lipjan.rks-gov.net/news/mbahet-debat-publik-per-te-diskutuar-draft-planin-komunal-per-ri-integrimin-e-qendrueshem-te-personave-te-riatdhesuar-dhe-integrimin-e-te-huajve-ne-komunen-e-lipjanit-2026-2028/>

Drejtori për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale Shkëlzen Hajdini edhe njëkohësisht kryesues i komisionit për hartimin e këtij Draf Planit e hapi takimin me ç'rast ai ka përshëndetur të gjithë të pranishmit duke i falenderuar për pjesëmarrje ka thënë se ky draf plan është hartuar në përputhje me sugjerimet, kërkesat dhe kontributet e përfaqësuesve të ndryshëm nga Komuna e Lipjanit, të cilët janë caktuar nga Kryetari i Komunës, si zyrtarë të drejtorive të ndryshme komunale.

Për realizimin e këtij Draf Planit, Kryetari i Komunës së Lipjanit kanë marrë vendim për themelimin e grupit punues për hartimin e Draft-Planit Komunal për Riintegrimin e Qëndrushëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunen e Lipjanit (2026-2028) me datë 19.01.2026. Ne përbërje si vijon:

1. Shkëlzen Hajdini-Drejtor për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale
2. Lidija Jovanovic – Zyra Lokale për Komunitete, anëtare
3. Arbresha Hetemi – Zyra Lokale për Komunitete, anëtare
4. Brahim Duriqi – Drejtorati për Arsim, anëtar
5. Behar Aliu – Drejtorati për Administratë, anëtar

Konsultimi publik u zhvillua në prezencën e një numër të konsideruar të pjesëmarrësve, me ç'rast kryesuesi Shkëlzen Hajdini ka theksuar se me qëllim që t'i ofroj publikut qasje të lehtë në mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave nga organet e komunës si dhe rritjen e mundësive të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimarrëse, ka prezantuar Projekt-Planin Komunal Planit Draft-Planit Komunal për Riintegrimin e Qëndrushëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunen e Lipjanit (2026-2028), duke thënë se Procesi i hartimit e deri te miratimi i këtij dokumenti nga Kuvendi i Komunës së Lipjanit kemi kaluar nëpër disa faza, nëpër të cilat janë zhvilluar aktivitete të ndryshme.

Kryesuesi Shkëlzen Hajdini, duke e prezantuar këtë plan ka thënë se ky Draf Plan është bazur në dy rregullore, rregulloren 22/2020 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar neni 36 paragrafi 2 si dhe neni 42 paragrafi 1, dhe rregulloren 09/2019 për Integrimin e të huajve, pasi që strategjia i përket vitit 2021-2025, për këtë arsye ZKKK-ë ka kërkuar informata nga MPB se a duhet të bazohet në strategjinë e vejtër apo vetëm me rregulloret, nga MPB kemi marrë përgjigje që të bazohemi vetëm në dy rregullore, andaj Komuna e Lipjanit e bëri hartimin e këtij "Draft-Planit Komunal për Riintegrimin e Qëndrushëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunen e Lipjanit (2026-2028) Ky Draf Plan është hartuar bazuar kryesisht në sugjerimet, kërkesat dhe kontributet e përfaqësuesve të ndryshëm nga Komuna e Lipjanit, të cilët janë caktuar nga vet komuna, si zyrtarë të drejtorive të ndryshme komunale, në këtë komunë, të cilët e kanë themeluar grupin punues Komunal për hartimin e këtij Draf Planit.

Pas konsultimeve dhe diskutimeve që ka zhvilluar Grupi Punues për hartimin Draft-Plani Komunal për Riintegrimin e Qëndrushëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunen e Lipjanit (2026-2028), ka vendosur që në kuadër të këtij plani të veprimit të përfshihen dhjetë objektiva, të cilat janë edhe pjesë e rregullores 22/2020, dhe rregullores 09/2019.

Grupi punues për hartimin e Draft-Plani Komunal për Riintegrimin e Qëndrushëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunen e Lipjanit (2026-2028) në Komunën e Lipjanit të përfshihen dhjetë objektiva si në vijim:

1. Avancimi i sistemit të ri integrimit për personat e riatdhesuar, duke aplikuar qasjen e orientuar në nevojat specifike për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve
2. Avancimi i sistemit të referimit të rasteve në skemat adekuate të ri integrimit të personave të
3. Avancimi i masave të ri integrimit dhe integrimit të qëndrueshëm ekonomik riatdhesuar dhe integrimit të të huajve
4. Avancimi i sistemit për ri integrim dhe integrim të mirëqenjes sociale të personave të riatdhesuar dhe të huajve
5. Përfshirja e fëmijëve të riatdhesuar dhe të huajve në sistemin edukativo arsimor
6. Integrimi social dhe informimi i të riatdhesuarve dhe të huajve, si dhe komunitetit pritës
7. Koordinimi ndërmjet akterëve lokal të përfshirë në procesin e riintegrimit të riatdhesuarve dhe integrimit të të huajve
8. Koordinimi i ndihmës financiare dhe teknike në nivel të komunës për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve
9. Ngritja e kapaciteteve të institucioneve dhe shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira të procesit të riintegrimit të personave të riatdhesuar dhe integrimit të të huajve
10. Monitorimi sistematik i qasjes së orientuar në nevojat për secilin kategori të personave të riatdhesuar dhe të huaj, bazuar në planin individual të riintegrimit dhe integrimit.

Tutje kryesusi Shëlzen Hajdini ka hapur diskutimit duke marrë kështu komente nga të pranishmit





Diskutimi u bë në mënyrë të hapur dhe u diskutuan shumë çështje, lidhur me Draft-Plani Komunal për Riintegrimin e Qëndrushëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunen e Lipjanit (2026-2028)

Gjatë këtij debati ka pasur edhe angazhime nga të pranishmit ku është diskutuar për çështjet të ndryshme dhe kanë kërkuar nga komisioni sqarime rreth këtij dokumenti.

Ne po i paraqesim pyetjet që janë parashtruar nga të pranishmit

Lumturia Bytyqi Hasani, ka thekësuar se ky plan duhet të prezantohet edhe në mbledhjen e Komitetit për Komunitet.

Komisioni ka potencuar se është paraparë të konsultohet edhe në mbledhjen e Komitetit për Komunitet.

Brahim Duriqi, ka pyetur dhe ka sygjerruar që në objektivin e 5 duhet mu përfshirë edhe kostoja financiare për arsye që fëmijet po kanë nevojë për kurse të gjuhës shqipe dhe mesimit shtesë, prandaj është e nevojshme kostoja financiare.

Komisioni ka marrë për bazë komentimin dhe ka potencuar se do të planifikohet edhe kostoja financiare.

Takimi filloi në orën 10:00 dhe mbaroi në orën 11:30

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/konsultimin publik-kontribuuesve
30 ditë pranohen		13
30 ditë		

Në këtë takim konsultativ kanë marrë pjesë **13** pjesëmarrës, prej tyre femra **9** dhe meshkuj.

Komentet nga debati konsultativ lidhur me Draft–Planin Komunal për Riintegrimin e Qëndrushëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunen e Lipjanit (2026-2028)

Temat e konsultimit	komentet	Kush ka komentuar	Pergjegja ne pyetje komente	Komenbtet (i ptranimi dhe mos pranimi)
Draft–Plani Komunal për Riintegrimin e Qëndrushëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunen e Lipjanit (2026-2028)	Ka thekësuar se ky plan duhet të prezantohet edhe në mbledhjen e Komitetit për Komunitet.	Lumturia Bytyqi Hasani,	Komisioni ka potencuar se është paraparë të konsultohet edhe në mbledhjen e Komitetit për Komunitet.	Komenti u pranua plotësisht
Draft–Plani Komunal për Riintegrimin e Qëndrushëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunen e Lipjanit (2026-2028)	Ka pyetur dhe ka sygjerruar që në objektivin e 5 duhet mu përfshirë edhe kostoja financiare për arsye që fëmijet po kanë nevoj për kurse të gjuhes shqipe dhe mesimit shtesë, prandaj është e nevojshme kostoja financiare.	Brahim Duriqi,	Komisioni ka marrë për bazë komentin dhe ka potencuar se do të planifikohet edhe kostoja financiare.	Komenti u pranua plotësisht

Gjatë fazës së diskutimit publik lidhur **Draft–Plani Komunal për Riintegrimin e Qëndrushëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të Huajve në Komunen e Lipjanit (2026-2028)** Komisioni për hartimin e saj ka shqyrtuar me kujdes të gjitha rekomandimet e pranuar nga palët e interesuara

Takimi filloi në orën 10:00 dhe mbaroi në orën 11:15

Bukurie Zejnullahu-Jashari

Zyrtare përgjegjëse për kordinimin e konsultimeve publike



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

[illegible]

[illegible]